



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.4.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË TË UNIVERSITETIT TË
PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga Fejzullah Fejza (Udhëheqës Ekipi), Florë Berisha, Adelina Selmani dhe Nora Rashiti.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	13
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	31
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Rektorin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 27.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (duke përfshirë ekzekutimin e buxhetit dhe Auditimin e Brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinionit

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si *theksim i çështjes* ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në lidhje me pasuritë fikse, obligimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente janë të pasakta. (ISSAI 200: **Opinionit i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes**).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

- Vlerat e pasurisë së gjithmbarshme të regjistruara dhe shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare janë jo të plota për vlera materiale;
- Përkundër faktit se Pasqyrat Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, ato kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish;
- Më shumë se gjysma e rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm vitin e kaluar, (disa prej të cilave janë përsëritje e rekomandimeve nga vitet e mëhershme), nuk janë implementuar ende. Kjo mund të rezultojë në vazhdimin e dobësive të kontrolleve të brendshme dhe në praktika operacionale jo efikase në fushat kyçe të shpenzimeve;
- Rishikimi i kontrolleve të aplikuara nga Universiteti i Prishtinës në sistemet kyçe financiare ka identifikuar kualitet të dobët të raportimit financiar mbi të hyrat tek menaxhmenti i lartë; dhe
- Vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në fushën e pagave dhe mëditjeve; tek investimet kapitale dhe tek menaxhimi i të hyrave ku procedurat e aplikuara nuk ofrojnë siguri mbi saktësinë dhe plotësinë e të hyrave. Përveç kësaj, realizimi i buxhetit nuk ka qenë në nivel të pritur, veçanërisht tek investimet kapitale.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Rektori duhet të siguroj që:

- Do të analizohen arsyet edhe për shpalosjen jo të saktë të pasurive edhe për mos aplikimin e këshillës nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për ta adresuar këtë. Në 2014 duhet të implementohen proceset e duhura për të siguruar paraqitjen e drejtë të pasurive në Pasqyrat Vjetore Financiare;
- Në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave financiare, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;

- Përgatitjes së buxhetit i paraprinë një proces gjithëpërfshirës dhe saktë i vlerësimit të nevojave i cili i pasqyron të gjitha informatat përkatëse, përfshirë rezultatet e viteve paraprake dhe ndryshimet e pritura për vitin e ardhshëm;
- Të rishikohet funksionimi i softuerit SEMS për të përcaktuar nëse problemi është tek dizajnimi i softuerit apo tek aplikimi i tij. Duke i ndjekur rezultatet e këtij rishikim të përcaktohen dhe merren masat adekuate për të eliminuar defektet dhe për të siguruar raportim korrekt të të hyrave dhe harmonizim adekuat të informatave;
- Të kryejë një rishikim të hollësishëm për të përcaktuar se pse kërkesat e prokurimit nuk janë respektuar në të gjitha prokurimet, dhe të identifikojë masat e duhura që dobësitë e identifikuara janë adresuar në mënyrë efektive. Në veçanti duhet të rishikohen kontratat që nuk po realizohen nga ana e kontraktorëve dhe të konsiderohet veprimet ligjore për realizimin apo ndërprerjen e tyre;
- Të rishikoj rastet e identifikuara tek pagat për të identifikuar dështimet në zingjirin e kontrolleve aktuale të procesimit të pagesave dhe monitorimin e vijueshmërisë së orëve mësimore, dhe për të përcaktuar veprimet adekuate që mundësojnë që procesimi i pagave të përputhet me evidencat e orëve të mbajtura. Puna jashtë orarit të planifikohet me saktësi dhe që kompensimet për punë jashtë orarit arsyetohen dhe mbështeten me dokumentacionin e duhur;
- Një proces efikas të menaxhimit të pasurive i të gjitha pronave dhe evidentimi i tyre në një regjistër gjithëpërfshirës do të ishte si pikënisje për vlerësimin dhe shpalosjen e saktë të tyre në Pasqyrat Financiare;
- Procesi i raportimit të detyrimeve kontingjente është adekuat dhe i përmban të gjitha shpalosjet e nevojshme në funksion të plotësisë së informatave në Pasqyrat Vjetore Financiare. Duhet të aplikohen të gjitha mundësitë ligjore për qartësimin e këtyre detyrimeve dhe në rast se vërtet janë obligime të Universitetit atëherë duhet të planifikohet kryerja e tyre në kohë reale; dhe
- Të shqyrtojë funksionimin aktual të sistemit të auditimit të brendshëm dhe të konsiderojë forcimin e marrëdhënieve në mes të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit dhe Menxhmentit të Universitetit si përgjigje ndaj funksionimit aktual. Njëherit nga Komiteti i Auditimit të kërkohet që të jetë më aktiv, me qëllim që të ndihmoj Njësinë e Auditimit të Brendshëm në kryerjen e detyrave dhe Menaxhmentin në adresimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Përgjigja e menaxhmentit- auditimit për 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat e auditimit dhe është zotuar se do ti adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (këtu e tutje UP) të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa nga pohimet kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Cilësia e PVF-ve, pjesërisht ishte e mirë. Të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar por u identifikuan disa gabime jo materiale. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹ me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim i çështjes ne dëshirojmë të tërheqim vemëndjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në lidhje me pasuritë fikse, obligimet e papaguara dhe detyrimet kontigjente nuk janë të plota dhe të sakta. Kjo sipas SNKSP të bazuar në para të gatshme nuk ndikon në asnjërin nga dy pasqyrat financiare (Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme dhe raporti i ekzekutimit të buxhetit).

(ISSAI 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

¹ Termi “opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin “opinion i pakualifikuar” I përdorur në versionin paraprak të raportit të auditimit. Terminologjia e re është në pajtim me standardet e reja të INTOSAI-t. Për më shumë informacion referoju shtojcës I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 27.10.2013, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me procesin e konsolidimit të pasurive respektivisht plotësinë e pasurive. Ky është rrezik i anomalive materiale, nga i cili mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i identifikuar

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me konsolidimin e pasurisë nga njësitë akademike të UP respektivisht procesi i plotësisë së informatave për pasuritë në PVF ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme për të adresuar rrezikun e paraqitur.

E gjetura

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive në kontekst të PVF-ve për vitin 2013. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të jetë e saktë. Derisa menaxhmenti kishte ndërmarr disa veprime për ta përmirësuar regjistrimin e pasurive të përvetësuara gjatë vitit 2013, rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti ka dështuar ti aplikoj përmirësimet e domosdoshme të kontrolleve. Ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë të pasakta për shumën 144,236€. Më tutje, komisionet për numrim dhe vlerësim të pasurive nuk kanë prodhuar raporte përkatëse brenda afatit të duhur kohor dhe nuk janë bërë konsolidimet e informatave të pasurisë.

Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë - Rektori duhet ti analizoj arsyet edhe për mos shpalosjen e vlerave të sakta të pasurive edhe për dështimin për ta zbatuar këshillën e ZAP për adresimin e këtij keq deklarimi. Në 2014 duhet të implementohen procese të përshtatshme për të siguruar prezantim të drejtë të pasurive në PVF.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013; dhe
- Rregulloret tjera relevante.

Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 16/12/2013, në lidhje me kornizën raportuese, nuk janë adresuar plotësisht nga Menaxhmenti. Ne kemi identifikuar mospajtueshmëritë si në vijim:

- Vlera e pasurive kapitale dhe jo-kapitale në pronësi të UP nuk është e plotë dhe nuk ishte konsistente me shpenzimet e vitit 2013 për investimet kapitale;
- Në kolonën realizimit kishte një mbivlerësim i pasqyrës së pranimit 3,865€ nga mosparaqitja e të hyrave të donatorit të brendshëm; dhe
- Shënimi 17, shuma e donacioneve nuk përputhet me shumën e paraqitura në tabelën kryesore.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të Draft PVF-ve në Ministri ishte jo korrekte për aspekte të rëndësishme të PVF-ve.

Rekomandimi 2 Prioriteti i lartë – Rektori duhet të siguroj se procesi i përgatitjes së PVF 2014 edhe formalisht përfshin rishikimin e draft llogarive nga menaxhmenti, me fokus të veçantë mbi fushat me rrezik të gabimit dhe ose/në fushat ku në vitet paraprake, janë identifikuar gabime.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga UP-ja kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet mujore për obligimet e papaguara;
- Draft planin dhe planin final të prokurimit;
- Raportin e Vet-vlerësimit; dhe
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga raporti i ZAP-2012.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

UP vetëm pjesërisht ka zbatuar Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të PVF për vitin 2012.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të UP-së ka rezultuar në 19 rekomandime. UP kishte përgatitur me vonesë planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve. Kjo mund të ketë ndikuar në mos adresimin me kohë të tyre ngase deri në fund të auditimit tonë për 2013, vetëm pesë rekomandime ishin adresuar plotësisht; tri pjesërisht dhe 11 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Më shumë se gjysma e rekomandimeve nga viti i kaluar nuk janë adresuar. Kjo për shkak që UP-ja nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të ZAP-it. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të vitit 2013 janë përsëritje nga vitet paraprake.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit për sistemet financiare kyçe, do të rezultojë në:

- Vlerën e pasurive të regjistruar jo saktë me rezultatin që opinioni të modifikohet apo të aplikohet Theksimi i Çështjes;
- Shpenzime jo të rregullta për pagat bazë dhe për angazhimet shtesë të stafit akademik; dhe
- Dobësi të përsëritura në menaxhimin e të hyrave vetanake dhe në sistemin e prokurimit.

Rekomandimi 3 Rektori duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë një afat kohor të pranueshëm për adresimin e rekomandimeve të bëra nga ZAP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat të rëndësishme më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet dhe të rishikohet nga Rektori në baza tremujore.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se dizajni i kontrolleve ekzistuese në disa fusha ka nevojë për rishikim në mënyrë që proceset të zbatohen siç është planifikuar dhe të funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm (AB) dhe Komiteti i Auditimit (KA).

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë vetë-vlerësimin e UP-së të ndërmarrë në kuadër të MFP në lidhje me vlerësimet e PEFA-s dhe vetë-vlerësimin e KBFP.

Ne kemi konstatuar se: ndërkohë që kontrollet mbi subvencionet janë në nivel të duhur dhe po zbatohen në mënyrë efektive, kontrollet mbi një sërë fushash tjera kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalohet që UP të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë e shpenzuar dhe menaxhim jo efektiv të njësive akademike. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i të hyrave vetanake, i sistemit të prokurimit me theks në investimet kapitale, si dhe menaxhimi i shpenzimeve për pagat.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për UP-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	27,659,128	29,570,626	26,001,380	25,113,788	24,576,014
Granti i Qeverisë - Buxheti	17,571,928	17,571,928	16,138,418	15,225,694	14,968,341
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	486,453	484,942	453,478	689,354
Të hyrat vetanake ⁴	10,087,200	10,087,200	8,893,360	8,951,376	8,475,287
Donacionet e brendshme	-	6,535	4002	9,465	3,500
Donacionet e jashtme	-	1,418,509	480,657	473,774	439,532

Buxheti final është për 1,911,498€ më i lartë se ai fillestar si rezultat i donacioneve; përfshirjes së të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak; dhe nga procesi i rishikimit buxhetor. Investimet kapitale, Subvencionet dhe transferet, dhe Mallrat e Shërbimet kanë pësuar rritje.

Në vitin 2013, UP ka përdorur 88% të buxhet final, një performancë kjo më e dobët për 6% krahasuar me vitin 2012.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat vetanake që janë përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	27,283,075	29,570,626	26,001,380	25,113,788	24,576,469
Pagat dhe Mëditjet	19,283,075	19,617,801	18,888,351	18,281,648	17,796,469
Mallrat dhe Shërbimet	3,130,860	4,620,401	3,203,258	3,593,185	3,543,985
Shërbimet komunale	1,061,191	901,191	884,842	930,500	1,048,754
Subvencionet dhe Transferet	1,314,000	1,501,233	1,292,455	1,236,970	1,028,864
Investimet Kapitale	2,870,000	2,930,000	1,732,474	1,071,485	1,156,942

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pjesa e pashpenzuar për paga dhe mëditje ka mbetur e pashpenzuar sepse rritja e planifikuar e numrit të të punësuarve u shty për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të UP-së, dhe angazhimit të stafit akademik me vonesë (një pjesë të stafit iu janë nënshkruar kontratat e punës në fund të vitit 2013);
- Buxheti për Subvencione përkundër që është rritur në krahasim me buxhetin fillestar nuk ka arritur që të realizohet në masën e duhur. Për pjesën e shpenzuar kontrollet e zbatuara ishin efektive;
- Kategoria e kapitaleve karshi buxhetit fillestar kishte rritje pas rishikimit buxhetor, mirëpo niveli i shpenzimit për këtë kategori ishte i dobët, me vetëm 59% të buxhetit të shpenzuar. Madje trendi i shpenzimit kishte dinamikën më të madhe në tremujorin e fundit, edhe pse një pjesë e mosrealizimit të buxhetit i dedikohet vendimit të Ministrit të Financave për pezullimin e nxjerrjes së Urdhërblereve në muajt e fundit të viti buxhetor, dhe
- Edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kishte një shpenzim jo adekuat karshi planifikimeve buxhetore dhe rrjedhës së parasë. Në këtë kategori niveli i shpenzimit ishte rreth 70%.

Rekomandimi

Çështja 4 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Përveç në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ekzekutimi i buxhetit te kategoritë tjera ekonomike nuk ishte në nivelin e pritur. Madje te kategoria e investimeve kapitale është ekzekutuar vetëm 59% e buxhetit të planifikuar, gjë që është një tregues i një performancë efektive.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit ka rezultuar në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 4** Rektori duhet të siguroj që përgatitjes së buxhetit i paraprinë një proces analize gjithëpërfshirëse i cili i pasqyron të gjitha informatat përkatëse, përfshirë rezultatet e viteve paraprake dhe ndryshimet e pritura për vitin e ardhshëm. Një monitorim në baza mujore do të shërbente për identifikim e arsyeve për një realizim të ulët të buxhetit dhe do të krijonte një bazë për veprimet e nevojshme për të rritur nivelin e ekzekutimit të buxhetit.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Pjesa më e madhe e të hyrave në UP kanë të bëjnë me tarifatat për shërbimet e studentëve te të gjitha niveleve të studimeve. Një pjesë e vogël e të hyrave inkasohet nga ofrimi i shërbimeve profesionale nga njësitë e UP-së (Fakultetet dhe Institutet) Të hyrat e realizuara janë pjesë përbërëse e buxhetit të UP-së dhe kryesisht përdoren për mbulimin e kostove të Pagave dhe Mëditjeve.

Të hyrat e planifikuara nga UP për vitin 2013 ishin 10,087,200€ ndërsa ishin arkëtuar 9,720,740€, apo 96%, por nga kjo normë e të hyrave rreth 431,420€ apo 4% i janë kthyer participantëve, duke bërë që saldo përfundimtare e të hyrave pas kthimit të jetë 9,289,320€.

Rekomandimet

Çështja 5 - Mosbarazim i shënimeve të brendshme për të hyrat- Prioritet i lartë

E gjetura Në softuerin Softueri Elektronik i Menaxhimit të Studentëve (SEMS), të cilin e përdor UP për regjistrimin e të hyrave, saldo në fund të vitit ishte 9,139,835€, ndërsa sipas shënimeve të Thesarit dhe BQK vlera e të hyrave të arkëtuara ka qenë 9,289,320€, që do të thotë se ka një diferencë prej 149,484€. Diferenca rrjedh nga mosbarazimi i të hyrave për janar dhe shkurt.

Përveq kësaj kishte diferenca në mes të shënimeve të SEMS dhe atyre që janë konfirmuar me dëftespagesa nga ana e zyrtarëve. Në softuerin SEMS saldo përfundimtare e të hyrave ishte 9,139,835€, ndërsa raporti i konfirmimeve të bazuara në dëshmi të pagesave të pranuar nga referentët ka qenë 8,231,600€, që rezulton me 908,235€ diferencë të shënimeve burimore në krahasim me raportin e SEMS. Kjo është pasojë e mos raportimit adekuat të njësive dhe poashtu nga fakti se përdorimi i softuerit nuk është duke u aplikuar si duhet nga Njësitë/Fakultetet.

Rreziku Dështimi në harmonizimin e shënimeve për të hyrat rrit rrezikun që objektivat e vendosura të mos implementohen dhe menaxhmenti të mos ketë informata të sakta për të hyrat. Kjo e ul efektivitetin e menaxhimit financiar, dhe lë të hapur mundësinë e mos zbulimit me kohë të keqpërdorimeve të mundshme.

Rekomandimi 5 Rektori duhet të shikoj të shikoj procesin e konsolidimit dhe të vendos ku janë problemet. Ai duhet poashtu të siguroj funksionimi i softuerit SEMS është i rishikuar për të përcaktuar nëse problemi është tek softueri apo tek aplikimi i tij. Në bazë të rezultateve të këtij rishikim të përcaktohen dhe merren masat adekuate për të eliminuar defektet dhe për të siguruar raportim korrekt të të hyrave dhe harmonizim adekuat të informatave.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Nën këtë kapitull, janë përfshirë të gjitha shpenzimet për Mallra dhe Shërbime dhe Investime Kapitale që kërkojnë zhvillim të procedurave të prokurimit.

Në memon e auditimit të perkohshëm ne kishim identifikuar disa dobësi dhe kemi dhënë këshillat tona të cilat ishin adresuar nga UP, mirëpo disa çështje ende mbetet të adresohen. Në veqanti janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Proceset e prokurimit nuk janë zhvilluar gjithmonë në përputhje të plotë me rregullat e prokurimit publik, dhe në disa raste nuk janë përzgjedhur procedurat e duhura.

Rekomandimi

Çështja 6 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi jonë mbi menaxhimin e prokurimit identifikoi çështjet në vijim (konkluzionet tona bazohen në vlerësim të dosjeve individuale dhe detajet e plota i janë ofruar menaxhmentit):

Ndarja e tenderve - procedurat e hapura në masë të madhe janë shmangur nga UP-ja përgjatë vitit 2013. Në shumë raste janë aplikuar kuotime të qmimeve në vend se të aplikohet procedura e hapur⁵.

Implementimi i kontratave për furnizim ka hasur në vështirësi për shkak se Operatorët Ekonomik (OE) kishin ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe më pas kanë refuzuar t'i furnizojnë kërkesat e UP-së.. Te kontrata për furnizime të materialit të zyrës OE kishte ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa artikuj, ndërsa ka refuzuar të plotësoj kërkesat e UP-së për materialin e kërkuar. Vështirësi në implementim kishte edhe te kontrata për mbushjen e klimave ku ishte ofruar çmim prej 1€ për mbushje të klimës, te kontrata për furnizim me tonerë dhe te kontrata për furnizim me pije për nevoja të UP-së.

⁵Në 2 pagesa të testuara për furnizim me kompjuter për nevoja të Rektoratit dhe Këshillit Drejtues kemi vërejtur se janë zhvillur dy procedura të veqanta. 2 pagesa të tjera për furnizim me fidane si dhe furnizim me rrap për kampusin universitar janë zhvilluar dy procedura të veqanta, poashtu edhe 2 pagesa për furnizim me telefona për Rektorat si dhe KD është përsëritur një gjë e tillë, procedura të ngjashme kemi pasur edhe tek furnizimi me ushqim voluminoz si dhe furnizimi me kemikate, kumulativi i këtyre pagesave ishte rreth 51,522

Faturimi i shërbimeve para kontraktimit - UP kishte lidhur kontratë me OE për shërbimet e DDD (Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinsketimit) në hapësirat e objekteve të UP-së. Mirëpo puna ishte bërë para nënshkrimit të kontratës. Në një rast tjetër, punimet ishin kryer para nënshkrimit të kontratës.(tek kontrata për “Bartje e inventarit” me vlerë 4,400€).

Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate - një numër i madh i transaksioneve ishin keq klasifikuar në reghistrimet e kontabilitetit. Tri (3) pagesa në vlerë prej 17,987€ për projektin “Renovim i Fakulteteve”⁶; 10,000€ për llotin 2 “Renovimi i objekteve” - Galeria e Arteve; dhe 13,525€ për projektin “Renovimi i objekteve, ishin rexhistruar ne kategorinë e mallrave, ndërsa i takonin kategorisë së investimeve kapitale.

Poashtu pagesa prej 16,965€ e cila lidhej me projektin “mjete konkretizimi për UP” dhe dy pagesa, njëra 97,719€ dhe tjetra 149,997€ për mobilje nën 1,000€ ishte bërë nga investimet kapitalet ndërsa i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Tenderi për “Furnizim me kartela” me vlerë prej 19,710€. tre herë ka qenë subjekt i shpalljes deri në përzgjedhjen e fituesit. Kriteret teknike dhe profesionale në të tri rastet e rishpalljes së njoftimit kishin ndryshuar nga versioni fillestar. Pos kësaj edhe fituesi nuk ishte i përgjegjshëm në kërkesat teknike dhe profesionale që kërkoheshin në dosje.

Rreziku

Mos aplikimi i procedurave adekuate sjell deri te furnizimet me çmime më të shtrejta; refuzimi për liferimin e furnizimeve nga ana e kontraktorëve mund ta vë në veshtirësi kryerjen e detyrave specifike brenda UP-së; kryerja e punëve para nënshkrimit të kontratave është në kundërshtim me normat ligjore; klasifikimi i gabuar i shpenzimeve ul efektivitetin e raportimit financiar, menaxhimin e buxhetit dhe shkakton pasqyrim jo korrekt të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi 6

Rektori duhet të kryejë një rishikim të hollësishëm për të përcaktuar pse implementimi i kërkesave të prokurimit nuk janë përmbushur, dhe të identifikojë masat e duhura që dobësitë e identifikuara janë adresuar në mënyrë efektive. Në veqanti duhet të rishikohen kontratat që nuk po realizohen nga ana e kontraktorëve dhe të konsiderohet veprimet ligjore për realizimin apo ndërprerjen e tyre.

⁶ Pagesat me vlera 1,483€,8,229€ dhe pagesa 8,274€

Çështja 7 - Dobësi jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

Shpenzime pa aplikuar procedura të prokurimit - UP kishte bërë pagesë prej 4,170€ për Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL) për shfrytëzimin e skanerit për përpunimin e testeve të provimit pranues në Fakultetin Ekonomik. As procedurat e prokurimit nuk janë përdorur as ndonje ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e këtij skaneri nuk është bërë. Për më tepër, nuk kishte as raport të pranimit të këtij shërbimi. Poashtu UP kishte blerë pajisje për ndriçimin e kampusit universitar në vlerë 504€, me kërkesë të Këshillit Drejtues, pa aplikuar procedurë të prokurimit.

Rreziku Mos aplikimi i procedurave të prokurimit në furnizimet e lartëpërmendura ka rezultuar në shpenzime që janë në kundërshtim me rregullat financiare.

Rekomandimi 7 Rektori duhet të siguroj një plan veprimi sa më të shpejtë për sa i takon qështjes së ngitur në mënyrë që UP-ja të ndërpresë praktikatat e tilla të shpenzimit të parasë të pambështetura në marrëveshje kontraktuale.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Testimet tona nga kategoria e shpenzimeve të cilat nuk i janë nënshtruar procesit të prokurimit kanë rezultuar me disa mangësi. Subjekt i përmirësimeve duhet të jenë trajtimi i kontratave për shërbime të veçanta në UP.

Rekomandimi

Çështja 8 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioriteti i lartë

E gjetura Në 12 raste Universiteti i Prishtinës kishte punësuar punonjës mbi bazën e Kontratave për shërbime të veçanta pa konkurs të hapur publik. Të gjithë ishin të kontraktuar për punë administrative deri në muajin Qershor.

Rreziku Angazhimi i punëtorëve përmes kontratave për shërbime të veçanta për punë administrative përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe njëherit krijon mundësinë që të ndodhin shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 8 Rektori duhet që të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta për angazhimin e zyrtarëve administrativ si dhe të siguroj që procesi i rekrutimit të jetë i hapur dhe konkurrues.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 19,617,800€ ndërsa shpenzimet ishin 18,888,351€ apo shprehur në përqindje rreth 96.2% e buxhetit. Numri i stafit të planifikuar ishte 2,155, ndërsa në dhjetor 2013 ishin 2,414 të punësuar. Arsyeja për tejkalimin e numrit të punësuarve në listën e pagave është sepse figuron stafi akademik (përkohësisht të pa angazhuar) me pagë zero të cilët nuk janë hequr nga lista e pagave.

Rekomandimet

Çështja 9 - Vijueshmëria jo e plotë e procesit mësimor dhe kompensimi joracional ndaj stafit akademik - Prioriteti i lartë

E gjetura Për pagesat e bëra për pesë profesorë në Fakultetin e Mjekësisë në vlerë të përgjithshme prej 10,170€, nuk na janë ofruar dëshmitë për vijueshmërinë e procesit mësimor për semestrin dimëror 2013/14. Arsyetimi ishte se përgjatë afatit të regjistrimit të studentëve (gjatë tetorit) vijueshmëria e orëve ishte e çrregullt edhe pse stafi akademik ishte i angazhuar në vendin e punës. Kjo gjë është konfirmuar edhe nga menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë.

- Në 17 raste personeli akademik me kontratë të rregulltë nuk kishte vijuar procesin mësimor në harmoni me kontratën e tyre të punës (është dashur të mbajnë nga 24, ndërsa kanë mbajtur nga 18 orë në muaj);
- Në nëntë raste kishte dallime në mes raportit për pagesë dhe orëve të mbajtura nga profesorë të rregulltë, me ç'rast janë mbajtur më pak orë ndërsa janë evidentuar dhe paguar më shumë;
- Në katër raste, profesorët janë kompenzuar për festa zyrtare dhe nuk janë bërë zëvendësimet e orëve që duhet të mbahen;
- Në një rast është tejkaluar norma e orëve të mbajtura mbi normë të përcaktuara sipas kontratës; dhe
- Në një rast në Fakultetin Juridik është kompensuar një asistente, pasi që i është hequr masa e pezullimit të përkohshëm të marrdhënjes së punës. E njëjta gjatë kohës për të cilën është kompensuar retroaktivisht kishte shërbyer në mision diplomatik të Kosovës dhe nuk kishte dëshmi për angazhimin e saj në fakultet.

Rreziku Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë e procesit mësimor ngrit rrezikun se mund të bëhen pagesa për punën e cila nuk është bërë si dhe mund të shkaktoj humbje financiare për UP-në. Mungesa e konsistencës në mes orëve të mbajtura dhe kalkulimit të pagave rrit rrezikun që shpenzimet të jenë më të larta se shërbimi i pranuar, dhe kjo përbën humbje financiare për UP-në.

Rekomandimi 9 Rektori duhet të rishikoj dështimet në zingjirin e kontrolleve aktuale rreth procesimit të pagesave respektivisht monitorimin e vijueshmërisë së orëve mësimore. Bazuar në këtë të përcaktohen veprimet adekuate që mundësojnë procesimin e pagave në përputhje me evidencat e orëve të mbajtura. Aty ku shfaqen rastet e mosvijueshmërisë së orëve të aplikohen ndalesat në paga konform rregullores së aplikueshme për të ardhura personale.

Çështja 10 - Staf Akademik me dy paga primare-Prioritet i mesëm

E gjetura Në dy raste kemi vërejtur se stafi i angazhuar në UP kishte marrëdhënje pune edhe në një institucion tjetër (AKP). Në dy rastet paga është deklaruar si pagë primare tek të dy punëdhënësit. Në këto raste nuk janë respektuar kërkesat ligjore për deklarimin e punëdhënësit kryesor dhe atij sekondar.

Rreziku Mos deklarimi i punëdhënësit kryesor dhe atij sekondar shkakton aplikim të normave tatimore jo në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe ndikon që të hyrat e buxhetit të jenë më të vogla.

Rekomandimi 10 Rektori duhet ti rishikoj rastet e identifikuara për të qartësuar arsyet pse punëdhënësi kryesor nuk është deklaruar, dhe të përcaktohen masa adekuate që raste të tilla të mos ndodhin në të ardhmen.

Çështja 11 - Pagesa të pabaza për Komisione të ndryshme dhe punë tjera administrative - Pritoretet i lartë

E gjetura Për Seminarin ndërkombëtar XXXII për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është paguar vlera prej 25,000€ për organizimin e tij dhe stafin administrativ. Kjo pagesë ishte bërë në mungesë të tarifave të përcaktuara për pagesën ndaj secilës pozitë dhe angazhim.

- Për shkak të shtimit të vëllimit të punëve, obligimeve dhe përgjegjësiave gjatë periudhës së aplikimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj në studimet bachelor dhe master, zyrtarëve të Rektoratit dhe Administratës Qëndrore u është paguar vlera prej 69,132€. Nga kjo shumë janë paguar edhe disa zyrtarë për punë shtesë, puna e të cilëve nuk lidhet me studentët, si zyra e prokurimit, zyrtari i pasurisë, zotimit, IT-së, zyrtari certifikues, dhe auditorët e brendshëm. Ne nuk kemi gjetur raporte mbështetëse për obligimet dhe punët shtesë të kryera.
- UP përgjatë vitit 2013 me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm kishte paguar vlerën totale prej 371€ për anëtarët e Komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë. Komisionet ishin të ndarë sipas njësive akademike dhe kishte dallime në mes pagesave të anëtarëve.
- Sipas vendimit të Rektorit, një zyrtarë është angazhuar për detyra shtesë me pagesë 30% nga paga bazë (270€) deri në tetor 2013. Realisht, pagesa për punë shtesë përgjatë tërë vitit ishte 82% nga paga bazë dhe angazhimi ka vazhduar edhe pas skadimit të afatit.

Rreziku Pagesa e punëve shtesë në mungesë të dëshmive për punën e kryer rrit rrezikun që të bëhen pagesa të parregullta dhe pagesa për punën që nuk është kryer.

Rekomandimi 11 Rektori duhet të siguroj që puna jashtë orarit të planifikohet me saktësi dhe që kompensimet për punë jashtë orarit arsyetohen dhe mbështeten me dokumentacionin e duhur përfshi këtu raportet për punën e kryer dhe aprovimet nga mbikëqyrësit direkt të stafit të angazhuar.

Çështja 12 - Pagesat nga FIM - Prioritet i Lartë

E gjetura Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në UP në vitin 2006 nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit (MiM) me Ministrinë e Transportit dhe Post Telekomunikacionit, MASHT, dhe UP-në për të arkëtuar të hyrat nga Instituti i FIM-it. Përgjatë 2013 nga Instituti i FIM-it ishin mbledhur të hyra prej 105,460€, dhe të njëtat u kishin ndarë për stafin e angazhuar në bazë të formulës së përcaktuar të MIM. Kjo parashikon që 10% e të hyrave i ndahen zyrtarëve të UP-së dhe FIM-it si shtesa në paga. MIM nuk është vazhduar nga 2007 dhe si i tillë konsiderohet si jo valid, dhe në këtë kontekst pagesat e realizuara për UP-në dhe FIM janë të diskutueshme dhe të pa bazuara.

Rreziku Mungesa e dëshimve për punën e kryer apo përvetësimi i mjeteve në formë të shtesave për stafin akademik të FIM pa bazë të qartë, dhe pa dëshmi për kontributin e dhënë krijon mundësi që të ndodhin pagesa të rregullta dhe të bazuara që ndikojnë negativisht në buxhetin e UP-së.

Rekomandimi 12 Rektori duhet të siguroj që një MiM është dakorduar bazuar në një analizë të plotë të objektivave dhe procedurave.

Çështja 13 - Pagesa për orët e angazhimit në AKM- Prioritet i Lartë

E gjetura Për 10 profesorë të angazhuar në programin "Aftësimi dhe Kualifikimi i Mesimdhënësve" (AKM) ishte paguar shuma totale prej 44,820€⁷. Këto pagesa janë tejkaluara nga orët e mbajtura vërtetë nga këta profesorë. Vijueshmëria e tyre në ligjerata nuk ka qenë në përputhje me kontratat e tyre. Sipas kontratave, secili profesor duhet të mbajë 90 orë të ligjeratave, ose respektivisht 45 orë. Por, në fakt asnjë nga ta nuk e ka plotësuar këtë kërkesë. Vetëm pjesa prej 26,324€, është mbështetur me evidencat e vijueshmërisë, derisa për pjesën tjetër prej 18,496€ nuk janë gjetur evidencat e vijueshmërisë së stafit të angazhuar.

Rreziku Mungesa e dëshimve për orët e mbajtura rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta dhe të pa arsyeshme. Kontrollat e dobëta të aplikuar në monitorimin e vijueshmërisë dhe procedimin e pagesave në rastet e identifikuar rrit rrezikun që kjo dukuri të ndodh edhe te rastet e tjera. Kjo do të shkaktojë dëmtim të buxhetit të UP-së.

Rekomandimi 13 Rektori duhet të bëjë një rishikim të mekanizmave aktual të kontrolleve për të parë dështimet dhe për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e këtyre kontrolleve në AKM. Rastet e identifikuar nga auditimi do të duhej të shqyrtohen si çështje urgjente nga ana e menaxhmentit dhe masat administrative janë të nevojshme.

⁷ Pagesat ishin bërë në maj 2013 ndërsa lidheshin me semestrin 5 dhe 6 të këtij programi.

Çështja 14 - Pozitat drejtuese me pagë sekondare - Prioritet i lartë

E gjetura Në tri raste UP kishte paguar zyrtarë në pozita drejtuese mbi bazën e pagave sekondare. Pagesat për pagë primare ishin bërë për pozitën e profesorit të rregulltë. Madje, njëri prej tyre nga rektori ishte caktuar si ushtrues detyre i drejtorit për zhvillim akademik deri në muajin tetor 2012 mirëpo veprimtaria dhe pagesa ndaj tij kishin vazhduar edhe për gjashtë muaj shtesë.

Rreziku Pagesat e trajtuara më lartë janë në kundërshtim me Rregullorën e brendshme për të ardhurat personale ku ceket që zyrtarët mund të nënshkruajnë vetëm një kontratë të rregulltë pune. Njëkohësisht mund të shkaktoj rezultate jo të mira në punë pasi për udhëheqjën e pozitave drejtuese kërkohet angazhim i plotë kohor.

Rekomandimi 14 Rektori duhet të rishikoj angazhimet dhe kontratat jovalide bazuar në punën sekondare dhe të ndërmerr masa që këto veprime të mos përsëriten në të ardhmën.

Çështja 15 - Kontratat e personelit akademik në kundërshtim me Rregullorën e Brendshme për Paga – Prioriteti i lartë

E gjetura Në 46 raste kemi vërejtur që ishin lidhur kontrata mbi normë dhe në kundërshtim me Rregullorën e brendshme për të ardhura personale. Ajo qartëson se "personeli i angazhuar me dy marrëdhënie të rregullta pune (primare apo sekondare) nuk ka të drejtë të mbajë orë mbi normë" (të gjithë këta persona kanë dy marrëdhënie pune në Institucione Publike). Poashtu në një rast, profesori i angazhuar në dy Fakultete, atë të Bujqësisë dhe Ekonomikut për semestrin dimëror kishte zhvilluar procesin mësimor pa kontratë të rregulltë pune.

Në pesë raste Fakulteti Ekonomik kishte angazhuar staf akademik nga jashtë Universitetit dhe kontratat e tyre janë nënshkruar në vitin 2014. Realisht, angazhimi dhe pagesa ndaj tyre janë bërë përgjatë vitit 2013 pa ndonjë bazë ligjore.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave në kundërshtim me rregulloret e aplikueshme rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta dhe shpenzime të paplanifikuara. Kjo e ul efikasitetin dhe shkakton vështirësi në menaxhimin financiar.

Rekomandimi 15 Rektori duhet të siguroj që kontratat mbi normë të lidhura me personelin akademik janë të rishikuara për të përcaktuar arsyeshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre ligjore. Angazhimi i stafit akademik të bëhet në pajtim me rregulloret e Universitetit dhe pagesa ndaj tyre të bëhet konform kontratës. Aty ku ekzistojnë rastet e dy marrëdhënieve të rregullta pune (qoftë primare apo sekondare) të ndalohet mbajtja e orëve mbi normë.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

UP kishte shpenzuar shumën prej 1,292,455€ pra 86% nga buxheti i ndarë për Subvencione. Përfituesit mund të ndahen në entitetet publike, përfitues individual dhe pagesa për qeveri tjera.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

UP gjatë periudhës vitit 2013 ka hasur në vështirësi të menaxhimit të rexhistrave të pasurisë. Rexhistri i pasurisë nuk është gjithëpërfshirës ngase shumë prona dhe objekte nuk janë përfshirë në të. Përveq kësaj informatat e shpalosura në pasqyra rreth pasurive nën 1,000€ nuk ishin të sakta si rezultat i gabimeve gjatë konsolidimit të tyre.

Për më tepër, referoju kapitullit 2.2.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra përmbledhëse e obligimeve të shpalosura në PVF ishte 1,329,780€ ndërsa tek detajet e bashkangjitura janë ofruar informata për vlerën prej 1,264,358€, me një diferencë prej 65,421€.

Derisa tek pjesa e detyrimeve kontingjente kishte shpalosur shumën prej 1,843,470€. Nga kjo shumë, 1,500,000€ ishin a) obligim i UP-së ndaj Administratës Tatimore të Kosovës për mospagesën e tatimit në paga për stafin akedamik, b) 273,900€ lidheshin me një projekt për përkthimin e librave i cili është në proces gjyqësor, dhe c) 70,870€ lidheshin me obligime ndaj përfituesve individual të cilëve UP u kishte mbetur borxh për angazhimet e tyre në ofrimin e shërbimeve të ndryshme.

Rekomandimet

Çështja 16 - Mos raportim i duhur i obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Njësitë akademike përgjatë vitit 2013 nuk kishin raportuar për obligimet e tyre dhe si pasojë UP nuk ka arritur të inkorporonte shumat e sakta në PVF. Poashtu edhe në shënimet shpalesëse në PVF nuk janë konsistente tek raporti përmbledhës dhe analitika e tij.

Rreziku Mungesa e llogaridhënjes për obligimet nga ana e njësive akademike në formatet e kërkuara si për nevoja të brendshme poashtu edhe për raportim të jashtëm, lë hapur rrezikun se administrimi i borxhit nuk është adekuat.

Rekomandimi 16 Rektori duhet të siguroj një rishikim të linjave të llogaridhënies së raportimit të obligimeve nga të gjitha njësitë akademike, dhe të vendos kontrole efektive në mënyrë që niveli i borxhit mos të pengoj efektivitetin e operacioneve në të ardhmen.

Çështja 17 - Detyrimet Kontingjente- Prioritet i lartë

E gjetura Detyrimet kontingjente kanë të bëjnë me detyrime që rrjedhin nga kontratatat dhe marrëveshjet e nënshkruara nga UP, si dhe nga obligimet nga mospërbushja e obligimeve ndaj ATK-së. Standardet e kontabilitetit kërkojnë që për detyrime kontingjente të bëhen shpalesje dhe të jepen shënime adekuate shpjeguese për to. UP nuk kishte bërë shpalesjet dhe shënimet e duhura.

Rreziku Mungesa e shpalesjeve dhe shënimeve shpjeguese për detyrimet kontingjente shkakton paqartësi në PVF, derisa mos pagesa e tyre me kohë mund të shkaktojë humbje financiare.

Rekomandimi 17 Rektori duhet të siguroj se procesi i raportimit të detyrimeve kontingjente është adekuat dhe i përmban të gjitha shpalesjet e nevojshme në funksion të plotësisë së informatave mbi PVF. Duhet të aplikohen të gjitha mundësitë ligjore për qartësimin e këtyre detyrimeve dhe në rast se vërtetë janë obligime të UP-së atëherë duhet të planifikohet kryerja e tyre në kohë reale.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i Auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe e Kontrollit të Brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm në UP përbëhet nga 2 zyrtar, drejtori i AB dhe një zyrtar. NjAB posedonte Planin vjetor të aprovuar dhe të njëjtin kishte arritur ta realizojë në nivelin e duhur. Komiteti i Auditimit (KA) ka mbajtur 4 takime, dhe ka dhënë një kontribut në adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AB edhe nga ZAP. Edhe pse ky kontribut do të duhej të jetë edhe më i theksuar.

Rekomandimet

Çështja 18 - Mos fokusimi i NJAB në fushat me rrezik-Prioritet i lartë

E gjetura NjAB edhe përkundër faktit se kishte arritur të përmbushë planin vjetor konform dinamikës së paraparë, nuk është fokusuar në fushat me rrezik më të lartë siç janë pagat dhe mëditjet. Poashtu auditimet e NjAB nuk kishin mbuluar sa duhet proceset e vitit aktual sa kishte qenë e nevojshme. Cilësia e raporeve të NJAB nuk ishte shumë e kënaqshme, në lidhje me përmbushjen e standardeve profesionale.

Ndihmesa e KA në implementimin e rekomandimeve dhe përmirësimit të proceseve dhe kontrolleve të brendshme duhet të jetë më e fokusuar, marrë parasysh përgjegjësitë që ja jep korniza ligjore. Menaxhmenti i kishte adresuar rekomandimet në nivelin e kënaqshëm.

Rreziku Mos përfshirja në planin vjetor të fushave të cilat janë të përcaktuara me rrezik më të lartë mund të sjell rrezikun se AB nuk është duke e përmbushur në masën optimale funksionin e tij. Mos mbulimi i fushave me rrezik të lartë dhe orientimi i auditimit në proceset e vitit të kaluar e zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi 18 Rektori duhet të rishikoj funksionimin të sistemit të auditimit të brendshëm dhe të konsiderojnë forcimin e marrëdhënieve në mes të NjAB-së, KA dhe Menaxhmentit të UP-së. KA duhet të jetë më aktive në mënyrë që ta ndihmoj NjAB në kryerjen e detyrave dhe dhe Menaxhmentin në adresimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Pasqyrat Financiare	Menaxhmenti të siguroj se do të bëhet rishikimi i PVF-ve të ardhshme, para se ato të dorëzohen në ZAP dhe MF për tusiguruar që janë paraqitur saktë të gjitha informatat dhe shpalosjet.			Nuk është adresuar
Te hyrat	Të krijohen mekanizma adekuat që sigurojnë evidenca të sakta dhe raportime të rregullta mujore nga të gjitha njësitë akademike; Të bëhet harmonizimi mujor i shënimeve të brendshme me ato të bankës dhe thesarit. Theks i veçant duhet ti kushtohet aplikimit të softuerit për të hyrave në menyrë që të identifikohën dhe shmangen dobësitë eventuale të tij; kontrollet mbi procesin e evidentimit dhe raportimit të të hyrave; ndarja e përgjegjësisë të bëhet konform dispozitave të brendshme rregullative të UP-së.			Nuk është adresuar Nuk është adresuar

<p>Shpenzimet - Prokurimi</p>	<p>Rektori i UP-së të siguroj që: Dosjet e tenderit do të përmbajnë specifikacione teknike dhe kriteret të formuluar në mënyrë specifike, të qarta dhe të matshme si dhe vlerësimi i ofertave të bëhet konform tyre. Punët shtesë paraprakisht të aprovohen nga autoritetet relevante; Të siguroj që të aplikohen procedura efektive të prokurimit bazuar në vlerësimin real të kërkesave të UP-së. Të grumbullohen kërkesat e njëjësive për furnizime të njëjta në mënyrë që të përdoren procedurat e hapura të prokurimit për produktet e konsumit të përbashkët. Kjo do të ndikonte në efikasitetin e prokurimit si dhe në blerje me çmime më të lira. Në komisionet vlerësuese të caktoj persona me kompetencë në fushën e prokurimit, dhe vlerësimet e tenderëve të mbikëqyren nga menaxheri i prokurimit. Në rastet e dështimit të përmbushjes së kontaktave të aplikohen panalet, duke konsideruar edhe konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit. Poashtu duhet të merren masat adekuate, që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.</p>		<p>Pjesërisht është adresuar</p> <p>Pjesërisht e adresuar</p> <p>Pjesërisht është adresuar</p>	<p>Nuk është adresuar</p>
<p>Blerjet Tjera</p>	<p>Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj se do të monitorohet në baza të rregullta respektimi i limiteve të përcaktuara të shpenzimeve të karburanteve dhe telefonisë fikse. Në rast të tejkalimeve teprica të rimburohet. Për shfrytëzimin e automjeteve të plotësohen dokumentet standarde konform kërkesave për menaxhimin e automjeteve zyrtare.</p>	<p>Është adresuar</p>		

Pagat dhe Meditjet	<p>Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj që: Të gjitha dokumentet burimore ruhen konform dispozitave të aplikueshme ligjore, dhe të mos bëhen pagesa pa dëshmi relevante që mbështesin plotësimin enormës së kontraktuar.</p> <p>Që pagesat e pagave dhe honorarëve për personelin akademik të bëhen në bazë të evidencave të vijimsisë në procesin mësimor, duke respektuar rregullorën e të ardhurave personale në UP. Njëherit kontrollet që kanë të bëjnë me aprovimin e këtyre evidencave dhe procesimin e pagave duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat janë për shërbimet e kryera conform kontratave.</p> <p>Kontrollet e brendshme në fushën e kontraktimit të punës mbi normë dhe honorar të sigurojnë që të gjitha kontratat janë në harmoni me rregullorën e pagave.</p>			<p>Nuk është adresuar</p> <p>Nuk është adresuar</p> <p>Nuk është adresuar</p>
Subvencionet dhe transferet	<p>Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj që: Statusi i zyrtarëve administrativë me kontratë mbi vepër të rregullohet konform dispozitave ligjore dhe pagesat e tyre të klasifikohen konform planit kontabël.</p> <p>Në rastet e subvencionimit të studentëve, mjetet të transferohen drejtpërdrejt në llogaritë bankare të përfituesve.</p>	Është adresuar		
Pasuritë jofinanciare	<p>Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj se do të bëhet rishikimi i PVF-ve të ardhshme, para se ato të dorëzohen në ZAP dhe MF për tu siguruar që janë paraqitur saktë të gjitha informatat dhe shpalosjet (shpalosjet kishin të bëjnë me pasuritë).</p>			Nuk është adresuar

Detyrimet e papaguara	<p>Të mbahen evidenca të sakta të detyrimeve të papaguara dhe të prezantohën drejtë në pasqyrat financiare. Të bëhet vlerësim në baza mujore i gjendjes së detyrimeve të papaguara, duke i dhënë prioritet pagesave sipas vjetërsisë së tyre.</p> <p>Rekomandojmë Rektorin e UP-së të forcoj kontrollet në lidhje me menaxhimin e borxheve, dhe të siguroj që pagesat e faturave të bëhen konform afateve ligjore. Gjendja e krijuar me kontestet kontraktuale duhet të shqyrtohet, të përcaktohen shkaktarët dhe të merren masat adekuate për evitimin e tyre në të ardhmen, ngase të njëjtat mund ti krijojnë kosto shtesë UP-së.</p>			<p>Nuk është adresuar</p> <p>Nuk është adresuar</p>
Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që në aktivitetet e NjABsë, përveq tjerash të përfshihen edhe shpenzimet e pagave, si dhe të implementohën rekomandimet që dalin nga auditimet e brendshme		Është adresuar pjesërisht	